

Komuna Campi Bisenzio

Aplikimi për Buoni Spesa Covid_19

Nga dita e martë 14 prill 2020 ora 12.00 deri më datë 20 prill ora 12.00 [është e mundur të aplikohet përsëri për Buono Spesa*](#) (ndihmë ekonomike në formë kuponi e dhënë nga komuna për të bërë pazare ushqimore).

Aplikimi bëhet vetëm në formën ON LINE nëpërmjet faqes kryesore të Komunës.

Përpara se të aplikoni, verifikoni me kujdes kushtet që ju japin të drejtë për marrjen e këtij kuponi **Buono Spesa**, si më poshtë:

Një përmbledhje e shkurtër e këtyre kushteve

Familjet që nuk janë në ngarkim të asistentëve sociale do të kenë të drejtë të përfitojnë këtë kupon **Buono spesa** vetëm nëse plotësojnë kushtet në vijim:

- Kanë pësuar një ulje drastike apo deri në zero, të të ardhurave të tyre, nga të gjithë anëtarët e familjes për shkak të shpalljes të emergjencës epidemike që prej datës 31 janar 2020: duhet të specifikohet lloji i kontratës të punës (punëtorë me kontratë pa afat, punëtorë me kontratë me afat të caktuar, i/e vetëpunësuar, kontratë me kohë të kufizuar, kontratë në bazë të telefonatava) emri i punëdhënësit, data e mbylljes të marrëdhënies të punës;
- nuk** përfitojnë asnjë lloj ndihme sociale tjetër;
- nuk** përfitojnë asnjë lloj ndihme publike ekonomike (reddito di cittadinanza, Karta për blerje të zakonshme (carta di acquisti ordinaria) pension apo çek social, pension për paaftësi pune, kontribute ekonomike të ofruara nga komuna, ndihma të tjera të parashikuara nga INPS (si CIG, NASpI dhe dis-COLL) dhe në rast se po duhet të tregohet shifra mujore;
- nuk** jan titullar të një apo më shumë llogari bankare apo librezë kursimesh në banka apo postë, për të cilat shuma totale aktive bruto (lordo) deri më datë 31 Mars 2020, nuk kalon shifrën 6000 €, duke i shtuar asaj 2000 € për çdo anëtar tjetër të familjes, deri në shumën maksimale prej 10.000 €.
- Aplikuesi duhet të deklarojë gjithashtu, nëse një apo më shumë anëtarë të familjes janë përfitues të ndihmave ekonomike publike në mbështetje të të ardhurave familjare dhe sa është kjo shumë; në këtë rast shuma e kuponit **Buono spesa** do të jetë i reduktuar (deri dhe në zero) me një shumë të barabartë me vlerën e përgjithëshme mujore të këtyre ndihmave.

Për personat që janë në ngarkim të asistentëve social do të jenë këto të fundit që do të vlerësojnë situatën ekonomike dhe do të bëjnë sinjalizimet e duhura.

Për trung familjar nënkuptohet familja e regjistruar në gjëndjen civile të komunës, në datën e aplikimit për kuponin **Buono spesa**.

Disa udhëzime për plotësim të saktë të aplikimit

Aplikimi duhet të bëhet nga një pjesëtar i familjes ku asnjë anëtar tjetër në moshë madhore po merr një rrogë të plotë për të përmbushur kërkesat jetësore, më esenciale dhe urgjente për shkak të masava të marra për ndalimin e epidemisë.

Aplikuesi duhet të tregojë të gjithë emrat dhe kodet fiskale të anëtarëve të familjes apo dhe të bashkëjetuesve të tjerë që ndodhen me të në të njëjtin trung familjar.

Derisa të pranohet aplikimi dhe të shpërndahet ky kupon **Buono spesa** duhet të jenë plotësuar të gjitha informacionet e kërkuara si më poshtë:

Në rast të punëtorëve me kontratë pa afat duhet të specifikohet nëse mbyllja e aktivitetit të punës ka sjellë si rrjedhojë:

- Mbyllje të marrëdhënies së punës, apo
- Ndërprerje të marrëdhënies së punës

Në të dyja rastet është e nevojshme të tregohet kush anëtarë i familjes ndodhet në këto kushte, emri i punëdhënësit apo të kompanisë, dhe data kur ndodhi e cila duhet të jetë pas 31 janar 2020.

Në rast të punëtorëve me kontratë me afat duhet të specifikohet nëse mbyllja e aktivitetit të punës ka sjellë si rrjedhojë:

- Mbyllje të marrëdhënies së punës, apo
- Ndërprerje të marrëdhënies së punës

Në të dyja rastet është e nevojshme të tregohet cili anëtar i familjes ndodhet në këto kushte, emri i punëdhënësit apo të kompanisë, dhe data kur ndodhi e cila duhet të jetë pas 31 janarit 2020.

Në rastin e vetëpunësimit duhet të deklarohet që aktiviteti personal nuk futet në listën e formuar sipas Dekretit të Ministrisë së Zhvillimit dhe e Ekonomisë, të datës 25 Mars 2020; të tregohet anëtar i familjes që e ka dhe të shjehohet në detaje aktiviteti duke përdorur dhe Kodin ATECO, si dhe data e ndërprerjes të saj.

Në rastin e punëtorit me kontratë me kohë të kufizuar apo me kontratë në bazë të telefonatava duhet të deklarohet që ka një ulje të fortë të punës, duhet të tregohet kush nga anëtarët e familjes është i prekur, punëdhënësi apo Kompania/Enti/Agjensia ku punonte, data e uljes së volumit të punës që duhet të jetë pas 31 janar 2020.

Në të gjitha rastet e lartpërmendura, zyrat e komunës në fazë kontrolli mund t'i këkojë çdo të interesuari dokumentacionin e nevojshëm që vërteton këto deklarata.

Paralajmërim për plotësimin e aplikimit

Kujtojmë që çdo aplikim online për kuponin **Buono spesa** është i bazur në autoçertifikim, dhe për këtë arsye do t'i nënshtrohen verifikimeve dhe kontrolleve në bashkëpunim me zyrat e ndryshme (INPS, Regjistri I taksave, ANPR, etj) për vërtetësinë e tyre, gjithnjë në përputhje me ligjin mbi të dhënat personale dhe privatësinë. Këto verifikime dhe kontrolle do të bëhen në kampion.

Në rast se Komuna vërteton deklarime të rreme, atëherë ajo do të vazhdojë me marrjen mbrapsht të shumës së dhënë si dhe me denoncimin në autoritetet gjyqësore.

Si do të shpërndahet kuponi Buono spesa

Pasi janë bërë kontrollet dhe verifikimet e duhura, ata që kanë të drejtë përfitimi do të kontaktohen nëpërmjet telefonit, në numrin e lënë gjatë aplikimit, nga zyrat e komunës për datën, orën dhe vendin ku mund të tërhiqet kuponi Buono spesa.

Kuponi mund të tërhiqet vetëm nga personi që ka bërë aplikimin, duke u prezantuar me një dokument identifikimi të vlefshëm. Për qytetarët e huaj që nuk bëjnë pjesë në BE, kujtojmë që duhet të kenë me vete dhe lejen e qëndrimit të vlefshëm (permesso di soggiorno).

Dyqanet që pranojnë kuponin **Buono spesa**

Këtu mund të konsultoni [listën e përditësuar të dyqaneve](#) që pranojnë kuponin **Buono spesa**

Informazione dhe njohuri të mëtejshme

Në faqen e internetit [Buoni spesa emergenza COVID 19](#) janë të shpjeguara në detaje kriteret dhe kufijtë për të përfituar kuponin **Buono spesa**, duke ndjekur të njëjtat udhëzimeve për komunat që bëjnë pjesë në Zonën fiorentine veri/perëndim; në të njëjtën faqe gjeni dhe shumën mujore të kuponit e llogaritur në bazë të anëtarëve të familjes që ndodhen të regjistruar në gjendjen civile.

Vetëm për informacione mund të telefononi nga e **hëna** në të **premtë** nga **ora 9.00 deri më 13.00** në numrin e telefonit **055 8959681** ose të dërgoni një email në adresën buonispesa@comune.campi-bisenzio.fi.it

Sportello Accoglienza cittadini stranieri

Zyrë pritjeje për qytetarët e huaj:

Villa Montalvo, Rr. di Limite 15 - Campi Bisenzio

Orari i hapjes Vetëm për telefon: 055 8959302

të martë 9.00 me 13.00;

të mërkurë 9.00 me 13.00;

të enjte 15.30 me 18.00.

[e-mail: accoglienza@comune.campi-bisenzio.fi.it](mailto:accoglienza@comune.campi-bisenzio.fi.it)